



Pranuar / Dorezuar Pimbeno / Prodato Received / Delivered	20.02.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Jednitca Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSACK	1924/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.32/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.32/2023 të datës 10.01.2023 të parashtruar nga ankuesit _____ dhe _____ nga Vushtrria, kundër organit të punësimit Komuna e Vushtrrisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", në mbështetje të Nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, Nenit 16 paragrafi 3 dhe Nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 20.02.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.32/2023 e datës 10.01.2023, e parashtruar nga ankuesit _____ dhe _____

A r s y e t i m

Ankuesit _____ dhe _____ nëpunës civil në marrëdhënie pune në Komunën e Vushtrrisë, më datë 10.01.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 102/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për njohje të së drejtës së kompensimit e pushimit vjetor të pashfrytëzuar për vitin 2021, dhe atë për ankuesin _____ kompensimin e njëmbëdhjetë (11) ditëve, ndërsa për ankuesin _____ kompensimin e dhjetë (10) ditëve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 16.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa me datë 20.01.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me këtë çështje administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 102/2023 të datës 10.01.2023 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqvrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën/ emailin e datës 07.07.2022 dhe 02.12.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 07.07.2022 nga për ankuesin Kërkesën për pushim vjetor për periudhën 16.06.2022 deri më datë 30.06.2022 nga ankuesi Kërkesë për pushim vjetor për periudhën 17.06.2022 deri më datë 30.06.2022 nga ankuesi Emailin e datës 14.06.2022 nga për ankuesin Kërkesën me numër protokollit 936/22 të datës 15.07.2022 nga ankuesi për Kryetarin e Komunës së Vushtrrisë; Vendimin me numër protokollit 1081/21 të datës 07.09.2021 nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 382/2023 të datës 16.01.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 621/2023 e datës 20.01.2023; Akt Emërimit me numër protokollit 862 të datës 01.02.2021 për ankuesin B.M; Përshkrimin e detyrave të punës për Drejtorin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm; Akt Emërimit me numër protokollit 859 të datës 01.02.2011 për ankuesin ; Përshkrimin e detyrave të punës për Auditor i Brendshëm; Emailin e datës 14.06.2022 nga ; Emailin e datës 02.12.2022 dhe 08.07.2022 nga për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës ka konstatuar se ankesa A.nr.32/2023 e datës 10.01.2023, e parashtruar nga ankuesit dhe është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesit janë të punësuar në Komunën e Vushtrrisë përkatësisht ankuesi sipas Akt-it të Emërimit me numër protokollit 862 të datës 01.02.201 është i emëruar dhe ushtron pozitën *Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm*, ndërsa, ankuesi sipas Akt-it të Emërimit me numër protokollit 859 të datës 01.02.2011 është i emëruar dhe ushtron pozitën *Auditor i Brendshëm* në Komunën e Vushtrrisë. Të njëjtit nw muajin qershor 2022 kanë parashtruar kërkesë për pushimin vjetor për ditët e pashfrytëzuara të vitit 2021 dhe atë ankuesi për periudhën 16.06.2021 deri më datë 30.06.2021, ndërsa ankuesi për periudhën 17.06.2021 deri më datë 30.06.2021, mirëpo që kërkesa në fjalë nuk ishte aprovuar. Ankuesit serish më datë 02.07.2022 i janë drejtuar me kërkesë Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore lidhur me kompensimin e pushimit vjetor të pashfrytëzuar për vitin 2021, ndërsa ky i fundit ka njoftuar ankuesit së për miratimin e kërkesës së ankuesve kërkohet miratimi i Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë si dhe i Drejtorisë për Buxhet. Pas kësaj, ankuesit me datë 15.07.2022 kanë parashtruar kërkesë me bazë të njëjtë të Kryetar i Komunës, ndërsa më datë 02.12.2022 kanë kërkuar nga Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore që të procedohet kompensimi i pushimit vjetor për shkak që Kryetari i Komunës ka aprovuar kërkesën për lejimin e kompensimit të pushimit vjetor për vitin 2021.

Lidhur me miratimin e kërkesës së ankuesve për kompensimin e pushimit vjetor të pashfrytëzuar për vitin 2021, Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave të lëndës nuk ka gjetur ndonjë shkresë apo akt administrativ përmes të cilit Kryetari i Komunës ka aprovuar kërkesën në fjalë të ankuesve, rrjedhimisht ndërlidhur me këtë, Kolegji verën kërkesën me numër protokollit 936/22 të datës 15.07.2022 të parashtruar nga ankuesi i e cila vetëm është nënshkruar nga Kryetari i Komunës pa specifikim së e njëjte aprovohet apo refuzohet, dhe si pasojë në vlerësimin e Kolegjit

mungesa e aprovimit të kërkesës së datës 15.07.2022 paraqet heshtje administrative të organit të punësimit në raport me këtë kërkesë të parashtruar nga ankuesit.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 98 paragrafi 2 me të cilin përcaktohet se: "2.Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj", si dhe nenin 127 me të cilin është përcaktuar se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ..." rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke marrë parasysh faktin së ankuesi veprimin e fundit lidhur me kompensimin e pushimit vjetor të pushfrytëzuar për vitin 2021 e kanë ndërmarr më datë 15.07.2022, data kjo që konsiderohet si ditë e inicimit të procedurës administrative, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa A.nr.32/2023 e datës 10.01.2023 është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e parashtruar jashtë afatit ligjor nuk është e pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.,Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.32/2023

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesionale

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve dhe
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

